



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија" бр.5, 1000 Скопје | тел.02/3218 130 факс.02/3218 131 | contact@ssrm.mk
Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel.02/3218 130 faksi.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Në bazë të nenit 44 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.102/19) dhe neni 17 paragrafi (3) n.I paragrafi (1) nga Regullorja e punës të Këshillit Gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.274/19, 186/20), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 29.12.2022 solli

RREGULLORE PËR NDYSHIM DHE PLOTËSIM TË RREGULLORES PËR PUNË TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Neni 1

Në Rregulloren për punë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.274/19 dhe nr.186/20) në nenin 10 paragrafin (3), pika në fund të fjalisë ndryshohet me presje dhe pas presjes shtohen fjalët: në rast ndryshimeve të rethanave në sallën e mbledhjeve radhitja e ulëseve të anëtarëve të Këshillit mund të ndryshoj.

Neni 2

Neni 28 ndryshohet dhe thotë

"Neni 28"

(1) Gjyqtari ose kryetari i gjykatës, ndaj të cilit zhvillohet procedura për përcaktimin e përgjegjësisë, nëse ka kërkuar nga përfaqësuesit e tyre të marrin pjesë në seancë, mund të njoftojë Shoqatën e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 61 paragrafi (4) nga Ligji për Gjykatat). Këshilli Gjyqësor njofton gjyqtarin apo kryetarin e gjykatës për të cilën po zhvillohet procedura, më së paku 7 ditë para seancës së Këshillit (neni 65 paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të RMV). Kur kërkesa për praninë e përfaqësuesit të Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është dorëzuar të paktën tre ditë pune para ditës së seancës të Këshillit Gjyqësor, Këshilli Gjyqësor e informon Shoqatën e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për datën e mbajtjes së seancës (përmes e-mailit, telefonatës ose në mënyra të ndryshe).

(2) Seanca e Këshillit Gjyqësor mbahet pamarë parasysh mos prezencën e përfaqësuesit të Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me kërkesë të gjyqtarit ose kryetarit, përfaqësuesi mund të hyjë në seancë në çdo kohë edhe pa ftesë paraprake. Në qoftë se

përfaqësuesi arinë gjatë seancës së filluar gjatë debatit për pikën e rendit të ditës për të përcaktimin e përgjegjësinë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, seanca nuk do të fillon nga fillimi.

(3) Nëse kërkesa për ngritjen e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës nuk i përmbanë të dhënat personale të adresës dhe vendbanimit i jetesës (neni 62 paragrafi (1) të Ligjit të Këshillit Gjyqësor), Këshilli si mbrojtës i të dhënave personale do të veprojë në bazë të kërkesës nëse aplikuesi ofron dëshmi se ai është përpjekur të sigurojë të gjitha të dhënat personale.

(4) Në diskutim për kërkesën ftohet edhe parashtruesi i kërkesës. Nëse parashtruesi i kërkesë është i ftuar në mënyrë të rregullt dhe nuk mer pjesë në diskutim të Komisionit, ndërsa nuk e vërteton mungesën, diskutimi i Komisionit dhe të mbahet. Të gjitha dëshmitë e dorëzuar nga ana e gjyqtarit apo kryetarit të gjykatës dorëzohen në qasje edhe deri te aplikuesi i kërkesës.

(5) Kërkesa për ngdritjen e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë së gjyqtarit apo kryetarim e gjykatës nuk mund të precizohet deri në mbarimin e diskutimit të Komisionit.

(6) Nëse me një kërkesë kërkohet përgjegjësi për disa gjyqtarë apo kryetar të gjykatave, zhvillohet një procedurë e vetme dhe sollën vendime individuale. Nëse ngritet procedurë për përgjegjësi për më shumë gjyqtarë apo kryetar të gjykatave, Komisioni raportues nëse ka arsye të justifikuar, mundët ta ndanë procedurën edhe pse ato arsye më nuk ekzistojnë mundët përsëri ti bashkoj. Nëse për të njëjtin gjyqëtar janë dorëzuar më shumë kërkesa për ngritjen e procedurës për vërtetimin e përgjegjësive, sipas të cilave procedura është në të njëjtën fazë, Komisioni i raportuesve që ka marrë i pari kërkesën mund të vendosë, për arsye të përshtatshmërisë dhe ekonomisë, bashkimin e procedurës, të zhvillojë një procedurë të vetme dhe Këshilli të sjellë një vendim të vetëm.

(7) Procedura për përcaktimin e përgjegjësive së gjyqtarit apo kryetarit të gjykatës konsiderohet se ka filluar nga dita kur Këshilli do të sjellë vendim për vazhdimin e procedurës.

(8) Secili pjesëmarës në procedurë individualisht i bartë shpenzimet e veta.

Neni 3

Kjo Regulare hynë në fuqi nga dita e sjelljes, ndërsa publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqenë e Këshillit Gjyqësor.

Nr.01-40/1
09.01.2023
Shkup

KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT
Kryetar,
Vesna Dameva